



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit(Glllogoc)

Zyra e Kuvendit të Komunës
Nr. _____ dt. _____ 2014



Nga :Kryesuesi i Kuvendit të Komunës- Z. Naim Bazaj

Për: Kryetarin e Komunës z.Nexhat Demakun

LËNDA:Dërgimi i akteve te miratuara nga Kuvendi i Komunës se Drenasit në mbledhjen e mbajtur më dt:26.05.2014

1. Vendim për ndryshimin dhe plotesimit te nenit 3.7 I Rregullores për tarifa,ngarkesa e gjoba Komunale me Nr.12-031-1409
2. Vendim për miratimin e Planit Komunal për efijencë të Energjisë- 2014-2020.
3. Vendim për plotesimin dhe ndryshimin e vendimit Nr.01-344-3562 te dt:18.06.2009 për planin zhvillimor Urban të Komunës se Drenasit
4. Vendim për ridestinimin e mjeteve nga projektet te mbetura nga kapitalet
5. Vendim për ridestinimin e mjeteve nga projektet te mbetura kapitale për Arsim
6. Vendim për aprovimin e mjeteve financiare shtesë për bursë Komunale për studentët e familjeve të Dëshmorve.

Më dt:30.05.2014

Drenas



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit (Glllogocit)
Zyra e Kuvendit të Komunës



Nr. 400-22679 dt 30.05 2014

Në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 2.3 dhe 8 të Ligjit Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal dhe nenit 34 pika 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës të Drenasit në mbledhjen e vet të rregullt të mbajtur me 26.05.2014 miraton këtë:

VENDIM

- I. Ndryshohet dhe plotësohet neni 3.7 paragrafët I, II, III dhe IV i Rregullores për tarifa, ngarkesa e gjoba komunale me Nr.12-031-1409 të datës 04.04.2014 me këtë përmbajtje si vijon:

3.7. GJOBAT PËR SHKELJËN E RREGULLOREVE LOKALE

1. Kjo Rregullore dhe Rregulloret tjera Komunale të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Glllogocit, përmbajnë dispozitat ndëshkuese për shkeljen e tyre.
2. Lartësitë e gjobave janë të bazuara në disproporcion me shkeljet e dispozitave të Rregulloreve Komunale,
3. Të gjithë subjektet të cilët nuk i përgjigjën pagesës së tarifave dhe ngarkesave komunale të parapara me këtë Rregullore do të kërkohet ekzekutimi i dhunshëm nëpërmes Organit përmbartues kompetent ndërsa dispozitat tjera të kësaj Rregullore mbeten të pandryshuara.

- II. Me këtë Vendim do të njoftohen Drejtoratet e Komunës dhe Arkivi i Komunës.

- III. Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e Miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlersimit të ligjshmërisë nga Pushteti Qendror.

Kryesuesi i Kuvendit

Naim Baza





REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit(Glllogocit)
Zyra e Kuvendit të Komunës

Nr. 312-22677 dt 30.9 2014

Në bazë të nenit 12 dhe 40 par. 1 pika h të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 9 ,pika 2 e Ligjit për Eficiencë të Energjisë, nr.04/L-016 dhe nenit 34 pika 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës të Drenasit në mbledhjen e vet të rregullt të mbajtur me 26.05.2014 miraton këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** Vendimi për Miratimin e Planit Komunal për Eficiencë të Energjisë -2014-2020.
- II. Hartimin e Planit Komunal për Eficiencë të Energjisë është hartuar nga Koordinatori për energjinë dhe Komisioni i Drejtoratit për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, në bashkëpunim me Agjencinë e Kosovës për Eficiencë të Energjisë dhe Zyrën e BE-së në Kosovë,në kuadër të projektit”Promovimi i Energjisë dhe Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë në Kosovë”
- III. Me këtë Vendim do të njoftohën Drejtoratet e Komunës dhe Arkivi i Komunës.
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e Miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe aprovimit nga ana e Agjencisë së Kosovës për Eficiencë të Energjisë

Kryesuesi i Kuvendit

Naim Bazaj





REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit(Gllogocit)
Zyra e Kuvendit të Komunës

12 Nr. 344-22686 dt 30.05. 2014

Në bazw të nenit 12 dhe 40 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 5 dhe 10 nënparagrafi 2.5 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor dhe nenit 34 pika 34. 6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës të Drenasit në mbledhjen e vet të rregullt të mbajtur me 26.05.2014 miraton këtë:

VENDIM

PER PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E VENDIMIT NR.01-344-3562 DT.18.06.2009 PËR PLANIN ZHVILLIMOR URBAN TË KOMUNËS SË DRENASIT

I .Me këtë Vendim plotësohet dhe ndryshohet neni II(dy) I TABELAVE PËR PARAMETRAT URBAN (faqe 154) dhe tani teksti I këtij ndryshimi ka këtë përmbajtje si vijon :

Propozim për ndryshimin e Indeksit të ndërtimit në PZHU të Drenasit

zonat	etazhiteti	indeksi ISHN		indeksi ISHD
		banim –zonat mikse	industria	
I	I-IV	0.3-0.4	0.6	MAX 2
II	III-V	0.4-0.5	0.6	MAX 2.5
III	IV-VII	0.4-0.6		MAX 3.0
IV	VI-VIII	0.5-0.7		MAX 3,5
V	VIII-X	0.7-0.8		MAX 6,8

II. Pjesët tjera të Vendimit të Planit Zhvillimor Urban të Komunës së Drenasit mbetet e pa ndryshuar.

III. Obligohet Drejtorati për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit të Komunës këtë Vendim të implementoj pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës.

IV. Ky Vendim hynë në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MPL-së.

Kryesuesi i Kuvendit



Naim Bazaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit (Glllogocit)
Zyra e Kuvendit të Komunës



Nr. 400-22684 dt 30.05 2014

Në bazë të nenit 11, 12 ,dhe nenit 40 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 8 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal nr.03/L-049 ,dhe neni 34 pika 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë me datën: 26.05.2014 miratoi këtë;

VENDIM

PËR REDESTINIMIN E MJETEVE

Neni 1.

Më këtë vendim, miratohet redestinimi i mjeteve për shpenzime kapitale. Redestinimi i mjeteve bëhet në programin buxhetor, Planifikimi Urban dhe Mjedis nga këto projekte :

- 1.Regullimi i shtratit të lumit në shumë prej :10,000.00€,
- 2.Ndërtimi i rrugës Bytyqi Behrami në shumë prej :6,031.00€,
- 3.Asfaltimi i rrugës në Fshatin Gradicë lagja Fazliu në shumë prej6,061.25€,
- 4.Ndërtimi i Urës në fshatin Qikatovë e Vjeter,Lagja Mehani në shumë prej: 11,393.00€
- 5.Asfaltimi i rrugës në Abri-Terdevc –Gullubovc faza e pare në shumë prej :...50,000.00€
- 6.Infrastruktura në Fushticë e Epërme6,000.00€

Gjithsej mjete të redestinuara në shumë prej:.....89,485.25€

Neni 2.

Mjetët për redestinim të përmendura në nenin 1. Të këtij vendimi,redestinohen në këto projekte kapitale:

- 1.Bashkëfinancimi i projekteve në shumë prej:.....39,485.25€
- 2.Asfaltimi i rrugës në Polluzhë në shumë prej :30,000.00€ dhe
- 3.Asfaltimi i rrugës lagja Sylka, Demaku , Hajdaraj , Hysenaj dhe Muliqi ne shumë prej20,000.00€

Gjithsej mjete të redestinuara në shumë prej:.....89,485.25€

Neni 3.

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit, dhe për zbatimin e tij do të kujdesen; Kryetari i Komunës, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, si dhe Drejtorati për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit

Kryesuesi i Kuvendit

Naim Bazaj





REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit(Gllogocit)
Zyra e Kuvendit të Komunës



Nr. 400-22681 dt. 30.05 2014

Në bazë të nenit 11, 12 ,dhe nenit 40 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 8 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal nr.03/L-049 ,dhe neni 34 pika 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë me datën: 26.05.2014 miratoi këtë;

VENDIM

PËR REDESTINIMIN E MJETEVE

Neni 1.

Më këtë vendim, miratohet redestinimi i mjeteve për shpenzime kapitale. Redestinimi i mjeteve bëhet në programin buxhetor, Drejtorati për Arsim nga projekti kapital “Ndërtimi i Shkollës fillore në Arllat” në shumë prej: **190,000.00€**.

Neni 2.

Mjetët për redestinim të përmendura në nenin 1. të këtij vendimi , redestinohen në këto projekte kapitale:

- 1.Mirëmbajtja e shkollave në shumë.....90,000.00€,
 - 2.Ndërtimi i aneksit të SHFMUnë Verbovc në shumë.50,000.00€,
 - 3.Renovimi i SHFMU “Xheladin Gashi-Plaku “ në Komoran në shumë
prej:.....50,000.00€
- Gjithsej mjete të redestinuara në shumë prej:.....190.000.00€**

Neni 3.

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit,dhe për zbatimin e tij do të kujdesen;Kryetari i Komunës, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, si dhe Drejtorati për Arsim.

Kryesuesi i Kuvendit

Naim Bazaj





REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit (Glllogocit)
Zyra e Kuvendit të Komunës



Nr. 400-22689 dt 30.05.2014

Në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dhe në bazë të nenit 34 pika 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e vetë të rregullt të mbajtur me dt.26.05.2014 aprovoi këtë:

VE N D I M
PËR APROVIMIN E MJETEVE FINANCIARE SHITESË PËR BURSË
KOMUNALE PËR STUDENTËT E FAMILJEVE TË DËSHMORVE.

Neni 1

Me këtë vendim aprovohen mjetet financiare shtesë në shumën prej 4000 € për 8 studentë të familjeve të dëshmorëve, nga 500 € për një studentë.

Neni 2

Që përfitues të bursës komunale në listën shtesë të përfituesve të bursës komunale të jenë studentet e familjeve të dëshmoreve pa marrë parasysh kriterin e notës mesatare gjatë studimeve.

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Drenasit dhe për aplikimin e tij do të kujdeset Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorati për Arsim.

Kryesuesi i Kuvendit

Naim Bazaj
Naim Bazaj

